



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**AD.GJTH.GJL.nr.4/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Kryetari i kësaj gjykate Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Edona Zuzaki, duke vepruar sipas ankesës të datës 03.08.2023, e parashtruar nga ankuesi N. D. nga fshati Kabash, Komuna e Vitisë, të paraqitur ndaj kolegjit shqyrtues në përbërje nga A. S., kryetar i kolegjit, D. S. dhe N. A., anëtarë të kolegjit dhe gjyqtarës së vetme gjykuese B. J. R., të gjithë gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Viti, për shkak të shkeljeve disiplinore, me datë 08.09.2023 mori këtë:

**AKTVENDIM**

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa e N. D. nga Vitia, për inicimin e procedurës disiplinore, e paraqitur ndaj kolegjit shqyrtues në përbërje të A. S., kryetar i kolegjit, D. S. dhe N. A., anëtarë të kolegjit, si dhe gjyqtarës së vetme gjykuese B. J. R.

**Arsyetim**

Ankuesi N. D., më datë 03.08.2023, i është drejtuar Këshilli Gjyqësor të Kosovës, Komisionit për Vlerësimin e Përformacës së Gjyqtarëve<sup>1</sup>, me ankesë, duke shprehur dyshimin e tij, lidhur me trajtimin e rastit nga organet e drejtësisë në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Viti, në të cilën thekson se trajtimin e rastit të tij e kanë trajtuar me neglizhencë dhe e kanë minimizuar tejmase, asnjëherë nuk është dëgjuar fizikisht nga gjykata apo prokurori i shtetit, ashtu që ankuesit në fjalë si e palë e dëmtuar në lëndën P.nr.4/22, i janë krijuar dyshime.

---

<sup>1</sup> Institucion ky që ankesën e ka drejtuar tek Autoriteti Kompetent.

Kryetari i gjykatës, pas analizimit të pretendimeve të palës ankuese, ka gjetur se ankesa e ankuesit N. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR], e datës 03.08.2023, është e pabazuar dhe se nuk plotësohen kushtet për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ndonjë gjyqtari të përfshirë në lëndën P.nr. 4/2022, për shkak se ankuesi në lëndën në fjalë nga shkresat<sup>2</sup> që vet i ka bashkëngjitur ankesës, vërtetohet se ka pasur cilësinë e palës së dëmtuar, ashtu që lidhur me mjetet juridike të cilat i ka ushtruar, gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Gjiçan – Dega në Viti, kanë vendosur brenda afatit të arsyeshëm, konform legjislacionit penal në fuqi.

Andaj konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i kësaj gjykate ka gjetur se ankesa është e pabazuara, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i gjykatës,  
Venhar Salihu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarëve A. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR], D. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR] N. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] dhe B. [REDAKTUAR] J. [REDAKTUAR] R. [REDAKTUAR]
2. Parashtruesit të ankesës
3. KGJK-së
4. Dosjes së lëndës.

<sup>2</sup> Aktvendimin P.nr. 4/2022 të datës 06.07.2023, Aktvendimin P.nr. 4/2022 të datës 20.07.2023 dhe faqen e dytë të Aktgjykimit P.nr. 4/2022 të datës 15.05.2023.